

Ky dokument nuk është prova. Prova janë bajtët e ruajtur: HTML-ja e faqes, pamja e saj, dhe zinxhiri i hash-eve që i lidh. Kjo dëshmi është paraqitja e tyre, e prodhuar automatikisht. Verifikohet me kodin më poshtë **pa na pyetur ne**.

ARTIKULLI

TITULLI	Von der Leyen shmang Serbinë dhe Bosnjën në turin e radhës në Ballkan, vizitat do të zhvillohen më vonë - Informohu siç duhet
ADRESA	https://radar.al/von-der-leyen-shmang-serbine-dhe-bosnjen-ne-turin-e-radhes-ne-ballkan-vizitat-do-te-zhvillohen-me-vone/
BURIMI	radar.al
GJENDJA	online

KOHA


KAPUR NGA NE	18 shtator 2026, 15:50:41 UTC <i>Dritarja jonë e pasigurisë: ± 900 s — intervali me të cilin e kontrollojmë këtë burim.</i>
DEKLARUAR NGA PORTALI	18 shtator 2026, 15:40:00 UTC <i>Koha e deklaruar vjen nga pala që po vlerësohet. Ora jonë nuk preket prej saj, dhe të dyja shfaqen këtu të ndara.</i>

HASH-ET · SHA-256

PËRMBAJTJA	b33d80b8de41544ab793e86af989d8dc1caa6160fa747a08be87d2fb014321f9
TEKSTI	dcd8a9d4ce4ad3724edf20e512f29ae56700d384a9c9b1fe3b93172a09a8ce97
PAMJA	9e07a7f9cbe5a22e73e0b7dc2f252c936756df5c12b94ee39cad5982fd01abf1

ZINXHIRI I PROVËS

KJO HYRJE	3736d799b9b644e7a9fd7b439e168d704ef8800a0f788868bf878f8d32fa17db
E MËPARSHMJA	—
RRËNJA MERKLE	0f7613a812b8a42978251c1471689408cbc054af17ff19ea88699c02ceb99882
ANKORIMI	submitted — dërguar, ende pa bllok <i>Deri te blloku, kjo provon integritetin, jo kohën.</i>



SKANOJE PËR TA VERIFIKUAR

Kodi të nxjerr te eksploruesi i STAMLES. Ai regjistër nuk është yni: nëse serveri ynë bie nesër, vula mbetet aty ku është.

Faqja tregon njërin nga tri gjendjet — **nuk u gjet, në radhë**, ose **e konfirmuar** me bllokun, rrënjën Merkle dhe transaksionin në Polygon. Krahazo hash-in që gjen atje me atë të shtypur më lart: nëse përputhen, kjo kapje ekzistonte para asaj ore, dhe ne nuk mund ta kishim ndryshuar pas saj.

<https://scan.stamles.eu/verify/3736d799b9b644e7a9fd7b439e168d704ef8800a0f788868bf878f8d32fa17db>

PAMJA E FAQES

Renderuar nga HTML-ja jonë e ruajtur, jo nga rrjeti. **Riprodhon kopjen tonë, jo pamjen e atëhershme:** stilet dhe imazhet e largëta mund të mos ekzistojnë më ose të kenë ndryshuar.

Motori: chromium-stored+assets · dritarja 1280×1024 px

YOU ARE AT: Home » Von der Leyen shmang Serbinë dhe Bosnjën në turin e radhës në Ballkan, vizitat do të zhvillohen më vonë

BOTË

Demo

Von der Leyen shmang Serbinë dhe Bosnjën në turin e radhës në Ballkan, vizitat do të zhvillohen më vonë

SEPTEMBER 18, 2026



Presidentja e Komisionit Evropian, Ursula von der Leyen, do të vizitojë katër vende të Ballkanit Perëndimor gjatë turneut të saj të radhës, ndërsa Serbia dhe Bosnje-Hercegovina nuk janë përfshirë në axhendën e kësaj vizite.

Turneu është planifikuar të zhvillohet nga 30 shtatori deri më 2 tetor dhe do të përfshijë Shqipërinë, Kosovën, Malin e Zi dhe Maqedoninë e Veriut. Gjatë vizitave, von der Leyen pritet të takohet me drejtuesit politikë të vendeve dhe të vizitojë projekte të financuara nga Bashkimi Evropian.

Zëdhënësja e Komisionit Evropian, Arianna Podesta, ka bërë të ditur se Serbia dhe Bosnje-Hercegovina nuk janë pjesë e programit të këtij turneu, ndërsa vizitat në këto dy vende do të zhvillohen në një moment të mëvonshëm, duke marrë parasysh proceset zgjedhore atje.

Ky zhvillim vjen në një periudhë me tensione të shtuara politike në Serbi dhe debate në nivel evropian lidhur me zhvillimet e fundit në rajon.

Në rastin e Serbisë, reagimet e BE-së janë ashpërsuar pas ceremonisë së varrimit të Ratko Mlladiqit, ish-komandantit serb të Bosnjës, i cili ishte dënuar me burgim të përjetshëm për gjenocid, krime lufte dhe krime kundër njerëzimit. Komisioni Evropian e ka kritikuar glorifikimin e kriminelëve të luftës dhe mohimin apo relativizimin e krimeve të luftës, duke i cilësuar këto si në kundërshtim me vlerat themelore evropiane.

Von der Leyen ka pasur ndër vite kontakte të shpeshta me presidentin serb Aleksandar Vuçiç, ndërsa qasja e saj ndaj Beogradit është komentuar dhe kritikuar nga aktorë të ndryshëm politikë e ekspertë të Ballkanit Perëndimor.

Mediat në rajon raportojnë se edhe disa deputetë të Parlamentit Evropian i kishin kërkuar presidentes së Komisionit të mos udhëtonte në Beograd në këtë periudhë.

Megjithatë, Komisioni Evropian ka sqaruar se mosvizita e tanishme nuk nënkupton ndërprerje të kontakteve me Serbinë apo Bosnje-Hercegovinën. Sipas Podestës, të dyja vendet janë parashikuar në një fazë të mëvonshme të turit të saj në rajon, duke marrë parasysh zgjedhjet e ardhshme.

Ky do të jetë turneu i radhës i von der Leyenit në Ballkanin Perëndimor, një traditë që presidentja e Komisionit e ka ndjekur prej vitesh përpara publikimit të paketës vjetore të raporteve për zgjerimin e BE-së. Në vitet e fundit, ajo ka vizituar në mënyrë të përsëritur vendet e rajonit për të diskutuar reformat dhe rrugën drejt anëtarësimit.

Gjatë vizitës së saj të ardhshme, fokusi pritet të jetë te procesi i integritit evropian, reformat,

Postimet e reja

Von der Leyen shmang Serbinë dhe Bosnjën në...

SEPTEMBER 18, 2026

Mickoski nga SHBA: Integrimi në BE duhet të...

SEPTEMBER 18, 2026

81 vite burg për ish-krerët e UÇK-së/ Çfarë kishte...

SEPTEMBER 18, 2026

Lady Gaga bëhet nënë për herë të parë, zbulon...

SEPTEMBER 18, 2026

Mos e humb

FOKUS | SEPTEMBER 15, 2026

Kompania e krijuar tri ditë pas hapjes së thirrjes për grantet e startupeve fitoi 6.1 milionë lekë në fazën e rezervuar për biznese të paktën 1-vjeçare

Pas shpalljes së listës së fituesve të "Grant 2026" kanë nisur të dalin rastet ku...

Skema sesi IUTE zbras fitimin nga Shqipëria, që ju merr konsumatorëve me interesa mbi 30%!

Skandal me sallamin në dyqanet Conad, thirrje konsumatorëve ta kthejnë mbrapsht

6 milionë euro të Startup Albania: Përfituesit, qokat dhe "problematicët"

Na ndiq

Facebook

Instagram

bashkëpunimi rajonal dhe zbatimi i Planit të Rritjes për Ballkanin Perëndimor.

YouTube

TikTok

“Siç tha presidentja në samitin e qershorit, Bashkimi ynë nuk do të jetë i plotë pa Ballkanin Perëndimor”, ka deklaruar zëdhënësja e Komisionit Evropian, duke theksuar rëndësinë e hapave të mëtejshëm në rrugën e vendeve të rajonit drejt BE-së dhe procesit të integritetit gradual, të mbështetur nga Plani i Rritjes për Ballkanin Perëndimor.

Në këtë kuadër, vizita e von der Leyen në Tiranë, Prishtinë, Podgoricë dhe Shkup do të jetë një tjetër ndalesë e rëndësishme në përpjekjet e Brukselit për të avancuar procesin e zgjerimit në Ballkanin Perëndimor.

SHARE.



RRETH NESH



Një shikim i thellë në botën e lajmeve, ku teknologjia dhe profesionalizmi takohen për të sjellë lajmet më të fundit dhe të rëndësishme brenda dhe jashtë Shqipërisë. Një burim i besueshëm për informacionin e saktë dhe analizat gjithëpërfshirëse.

NIPT: M47705501A

Email: radarlajme@gmail.com

Kontakt: +355689008000

HOROSKOPI

Universi ka një surprizë për këto 3 shenja më 14 shtator

Një ditë me surpriza në dashuri:
Horoskopi për të gjitha shenjat

Pak dramë, shumë ndjenja:
Horoskopi i dashurisë për këtë javë



Aleanca për
Media
Etike

Artikull joetik?

raporto këtu

© Radar.al. dizenuar nga 1001solutions

Pamja këtu është e ri-koduar për ta futur në dokument. Artefakti autoritar është skedari WebP i ruajtur, dhe hash-i i tij është ai i shtypur te faqja e parë — pra dallimi është i verifikueshëm, jo i fshehur.